

**AKT THEMELIMI I SHOQËRISË
“PIXEL STUDIO.AL” sh.p.k**

Ne mbështetje të Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, vendosa hartimin e këtij Akti Themelimi, me kushtet që përcaktohen si më poshtë:

Sot ne date 11.10.2024, ortaket e shoqerise:

z. ADHURIM KUÇAJ i datëlindjes 07.12.1988 shtetas Shqiptar, lindur në VLORE me ID I81207067T.

me vullnetin e tyre te lire dhe te plote, te shprehur nepermjet ketij akti themelimi, vendosi per krijimin e shoqerise tregetare "PIXEL STUDIO.AL" Shpk me kushtet e meposhteme:

**Neni 1
EMERTIMI**

Shoqeria Tregtare do te ketë Emërtimin " Pixel Studio / Pixel Shop / Pixel Marketing / Pixel Screen" Shpk.

**Neni 2
FORMA JURIDIKE**

Shoqeria Tregtare "PIXEL STUDIO.AL" Shpk, themelohet si Shoqëri Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar sh.p.k. Shoqëria është Person Juridik Privat Shqipëtar. Shoqëria krijohet në bazë të Ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, ku ne nenin 3 percaktohet se:

- " 1. Shoqëritë tregtare themelohen nga dy ose më shumë persona fizikë dhe/ose juridikë, që bien dakord për arritjen e objektivave ekonomikë të përbashkët, duke dhënë kontributet në shoqëri, sipas përcaktimeve në statutin e saj. Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare mund të themelohen edhe vetëm nga një person fizik dhe/ose juridik (shoqëritë me ortak apo aksionar të vetëm).
2. Shoqëritë tregtare duhet të regjistrohen sipas nenit 22 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, si dhe neneve në vijim, sipas formës përkatëse të shoqërisë tregtare.
3. Shoqëritë tregtare fitojnë personalitetin juridik në datën kur kryhet regjistrimi i tyre në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Shoqëritë përgjigjen me të gjitha aktivet e tyre për detyrimet, që rrjedhin nga veprimtaritë e ushtruara.”

**Neni 3
KOHEZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërisë "PIXEL STUDIO.AL" Sh.p.k do te vazhdoje veprimtarine e saj me një afat kohor te pakufizuar. Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj;


b) me vendim të ortakeve te shoqerise;

c) me hapjen e procedurave të falimentimit;

ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;

d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket e shoqerise marrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese “ Shoqeri ne likuidim e siper ”.



Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket e shoqerise.

Nëse Ortaket e shoqerise nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 4

SELIA

Shoqëria Tregtare "PIXEL STUDIO.AL" Sh.p.k e ka selinë ne qytetin e Rrugës Veledin Kollozi, Lagjia 29 Nëntori, Objekt Nr.7 Kat 1, Vlore 9401.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës se Shqipërisë, vetëm me vendim te Ortakeve te Shoqerise.

Neni 5

OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Shoqeria ka si objekt te veprimtarise se saj:

Shërbim foto, video, audio; Printime, Aksesorë fotografie; Organizim eventesh; Dizajn grafik dhe multimedia. Prodhim dhe montim adezivi, tabela dhe struktura të tjera orientuese. Menaxhim rrjetesh sociale. Shitje, blerje e pjesve elektronike dhe kompjuterike; Prodhim dhe publikim reklamash elektronike Led Wall; Blerje, shitje të të drejtave eksklusive dhe jo eksklusive në lidhje me elektronikën dhe fotografinë.

.

Neni 6

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqerise eshte i perbere nga kontributi i ortakeve themelues me vleren 100,000 lekë dhe perbehet nga 1 (një) kuote:

- **ADHURIM KUÇAJ** me kuote 100%

Neni 7


TRANSFERIMI I KUOTEVE

Kuotat e kapitalit jane lirisht te Transferueshme ndermjet Ortakeve. Ortaku qe kerkon te shese kuoten e tij nje personi te trete, duhet detyrimisht tu njoftoj ortakeve te shoqerise blerjen e kuotave te tij ne te njejtat kushte si personit te trete te cilit ai deshiron t'ia shese. Kur disa ortake ushtrojnë te drejten e tyre te parablerjes dhe shprehin deshiren e tyre per te blere kuoten, ortaku shites gezon te drejten diskrecionale per te zgjedhur se cilit ortak ai deshiron ti shese totalisht ose pjeserisht kuotat e tij. Ortaket duhet te pergjigjen brenda 30 diteve nese deshironjne te blejne kuotat e ofruara apo jo.

Neni 8

SHPERNDARJA E FITIMIT

Ortaket financojne, perfitorje rimbursim te financimit te tyre dhe ndajne fitimin e tyre ne baze te kuotave ne kapitalin themeltare.



Neni 9
ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE

Organet Drejtuese te Shoqërisë janë:

1. Administratori,
 2. Asamblea e Pergjithshme e Zakonshme ose e Jashtezakonshme e Ortakeve.
- Aministratori i Shoqërisë është Z. Klajdi KUÇAJ i datëlindjes 20.07.1997 shtetas Shqiptar, lindur në VLORE me ID J70720117W, me zotesi te plete juridike per te vepruar, posedues i leternjoftimit ID nr.032863850.**


Neni 10
KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

Administrator ushtron kompetenca ne emer te Shoqerise:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqerinë tregtare;
- c) kujdeset pér mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatis dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet pér shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente pérpara asamblesë së përgjithshme pér miratim;
- e) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur pér rrëthanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin pér Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- g) raportojë pérpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë pér veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori eshte i detyruar të thërrasi mbledhjen e ortakut te vetem edhe ne rastet kur:

- a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston reziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe
- b) kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 pér qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,
- c) Administratori ka të dreje të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtezakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqerinë pérpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat pér të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrëthanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.
- d) Administratori angazhon shoqerinë në marrëdhëni me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.



Neni 11

Veprimtaria ekonomike dhe financiare e shoqerise ndahet ne perjudha financiare 12 mujore. Viti finanziare fillon nga data 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor te cdo viti kalendarik,me perjashtim te vitit te pare i cili fillon nga data e krijimit te shoqerise dhe mbaron me 31 Dhjetor.

Neni 12

Shoqeria mban dokumentacionin e nevojshem financier per administrimin e pasurise dhe per zhvillimin e te gjithe veprimtarise se saj, ne perputhje me kerkesat e te gjithe legjislacionit perkates ne fuqi.

Bilanci financier i shoqerise perpilohet ne baze te raportit me shkrim te eksperteve kontabel te autorizuar dhe te raportit te paraqitur nga administratoret brenda dates 31 mars te vitit pasardhes. Te dy raportet paraqiten me miratohen ne asamblene e ortakeve brenda dates 30 qershor.

Fitimi neto i shoqerise llogaritet mbasi zbriten humbjet e mundshme te vitit te meparshem,shlyerja e te gjitha detyrimeve fiskale dhe ndaj cdo personi te trete,si dhe fondet financiare qe perbejne rezerven e detyrueshem.

Neni 13

ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

Mosmarrveshjet lidhur me themelimin dhe zhvillimin e veprimtarise se shoqerise zgjidhen nga vete ortaket e shoqerise me mirekuptim, dhe kur kjo nuk arrihet ato zgjidhen nga gjykata ne territorin e se ciles ndodhet selia e shoqerise.

Neni 14

Ky Akt Themelimi u hartua në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën Shqipe.

**ORTAKET E SHOQËRISË “PIXEL STUDIO.AL” Sh.P.K
ADHURIM KUÇAJ**

